

ZHVENDOSJA E MITEVE NË POEZINË E MIRKO GASHIT

Arsim HALILI

Së bashku me filozofinë, historinë edhe letërsia, gjatë gjithë kohës që nga antikteti e deri sot si burim krijues kanë shfrytëzuar mitet. Duke qenë se mitet janë nga më të ndryshme: kozmogonik, teologjike, estereologjik, etiologjik, po aq edhe tokësor e njerëzor. Secili veç e veç, ose në tërësi kanë zënë vend dhe si të tillë kanë pasuruar lëndën burimore të akcilës shkencë apo letërsisë në këtë rast. Letërsia shqipe në bashkëveprim me mitologjinë ka krijuar po aq sekuenca interesante që normalisht na fusin në atë botë konglomerateshë gjë që lexuesit i duhet të arrij me kujdes t'i zbërthej elementet mitike brenda një vepre artistike.

Një numër i konsideruar emrash të cilët kanë pasuruar letrësinë shqipe me elementet mitike e e që pa dyshim kanë lënë gjurmë janë: Pjetër Bogdani, Zef Serembe, Gjergj Fishta, Lasgush Poradeci, Ismail Kadare e disa emra të tjerë. Veç këtyre letërsinë tonë, qoftë për cilësia artistike, por edhe të jetuarit ndryshe nga të tjerët është Mirko Gashi. Ky emër do të lakohet disa herë gjatë këtij punimi. Në parantezë të këtij punimi le të sqarojmë disa çështje hyrse rreth përkufizimeve të mitit. Në fakt do të duhej të sqarojmë se ç'është miti letrar? *Nëse filozofia e shndërron mitin në përsiatje në mendim, letërsia atë e shndërron në kategorinë estetike të së bukurës. Ndërkaq në letërsi procedohet edhe me çmitizim, me risemantizimet letrare të mitit, me përmbysjen dhe ngritjen e tij ...*⁹⁴

Kur flitet për mitin, domosdo kemi shumë përkufizime të cilat secila në vete tregon jo vetëm rrjedhën, por edhe na jep një pasqyrim më të qartësuar rreth tij. *Miti është quajtur gramatikë e imagjinatës, një përmbledhje e imazheve simbolike, të cilat e përbëjnë të ashtquajturën e paveëdijshme kolektive të njerëzimit... prandaj mitin e veçojnë tri elemente themelore:*

- *Ahistorizmi*
- *Joobjektiviteti*
- *Universaliteti*⁹⁵

Struktura komunikuese e poezisë së Mirko Gashit interpretohet jo vetëm nga këndi artistik e estetik, por edhe nga qasja polisemantike.

⁹⁴ Prend Buzhala, Gjenetivi i lirikës (poezia e Mirko Gashit), shb Rozafa, Prishtinë, 2009, fq 24

⁹⁵ Osman Gashi, Letërsia dhe miti, botoi OM, Prishtinë, 2014, fq 51

Jeta mes bohemisë dhe letërsisë

Të shkruash në margjinat e këtij punimi për Mirko Gashin, nuk mund të thuhet e gjitha për të dhe rreth tij. Në Kosovë pas luftës së dytë botërore po i vinin themelet një plejade krijuesish të cilët lanë gjurmë jo vetëm për kohën kur jetuan dhe krijuan, por edhe sot letërsia e tyre artistike lexohet dhe ka peshë në aspektin studimor.

Plejada e krijuesve të kohës si : Esad Mekuli , Hivizi Sulejmani, Din Mehmeti, Enver Gjergjeku, Adem Gajtani , Azem Shkreli, Beqir Musliu , Musa Ramdani, Teki Dervishi, Ali Podrimja natyrisht në këtë plejadë hyn edhe Mirko Gashi. Djalë i bashkëshortëve të përzier, shkollën fillore e të mesme i vijon në gjuhën serbokroate, por dashurinë ndaj gjuhës atërore ia nxiti nëna, që siç shprehet vetë, vazhdimisht I thoshte : “Biro ti je shqiptar, mësoje gjuhën e babait tënd” . Kjo këshillë e nënës për Mirkon u bë obsession. Në moshën 17 vjeçare, nën përkujdesjen e Rizah Bicajt dhe Rexhep Elmazit fillon të mësoj shqipen , për të arritur aty ku ka arritur: të krijoj poezi në këtë gjuhë.⁹⁶

Pos që punoi mësues e gazetar në : Flakën e vëllazrimit” në Shkup, ka punuar edhe si aktor në Teatrin e Kombësive në Shkup,e ka kryer edhe shkollën e gazetarisë . Shtatë vite punoi gazetar në Radio Prishtinë, tri vite punoi gazetar në gazetën “Kosova” të Kastriotit (Obiliqit)⁹⁷... ka luajtur disa role nëpër filma dhe programe dokumentare, punoi edhe mësues në fshatratë e Preshevës si: Caravajkë e Raincë.

Sa qe gjallë ka botuar këta libra poetik:

- Në vorbullin e ujit , Rilindja Prishtinë, 1972, ribotimi 1981.
- Netët e bardha , Rilindja, Prishtinë, 1975
- Gjarpëri i shtëpisë, Rilindja Prishtinë,1981.
- Arbor vitae, Rilindja, Prishtinë 1988
- Liberto për gjenetivin e ujit, (Liberto za genativ vode), në gjuhën serbokroate, Jedinstvo, Prishtinë, 1977.

I njohur në rrethet letrare si bohem , udhëtimi poetik nëpër republikën e letrave shqipe, ta përkujton “ poetin bohem “ I cili nuk pajtohej me konventat e shoqërisë, prandaj doemos e bënte jetën vetën të veçantë, ashtu të dëshiruar, të vetëzgjedhur, si artist endacak duke bredhur midis realitetit dhe ëndrrës , midis jetës dhe vdekjes , midis gëzimit dhe vizionit.⁹⁸

Uji burim frymëzimi real dhe mitik.

Kur flitet për ujin, do të shtronim çështjen se kjo e mirë lëndore na nevojitet çdo ditë. Fakti real në jetë se uji është vet jeta, po aq i pranishëm është edhe në letërsi. Flitet mjaft për këtë dukuri natyrore , për këtë element kimik natyror,duket se edhe mitologjia, ka ditur të përmbledh disa specifika të ujit të cilat kanë lënë gjurmë. Duke qenë të rrethuar prej fuqive mitike, qoftë lëndore, apo dhe jo lëndore, vërtet edhe uji është një objekt letrar që shumë shkrimtarë, qoftë në poezi ose në prozë kanë futur me shumë finesë. Duhet theksuar një gjë se uji , apo ujërat janë përmendur mjaft nga lashtësia deri më sot, si e tillë për këtë dukuri lëndore janë ndërtuar mite nga më të ndryshme.

Ndalimi i ujërave ndër male ia vishnin përbindshit Kuçedër.Po atë e quanin shkaktare dhe të furtunave shkatërruese. Të tilla kushtet e jetës shoqërore e materiale të bujqëve e blegëtorëve bënin që të ruhen deri vonë rite në lidhje me ujrat dhe reshjet.⁹⁹

⁹⁶ Prend Buzhala, Gjenetivi i lirikës (poezia e Mirko Gashit), shb Rozafa, Prishtinë, 2009 , fq 44

⁹⁷ Po aty fq 45

⁹⁸ Po aty fq 46-47.

⁹⁹ Mark Tirta Mitologjia ndër shqiptarë, shb “Mësonjtorja”, Tiranë, 2004 , fq 307

Në përmbledhjen poetike “ Polipet e vdekjes “dhe në librat e tjerë të autorit Mirko Gashi , miti për ujin është mjaft i theksuar, gjë që semantikisht Mirko Gashi kur shkruan për ujin ai thjesht nuk e mendon atë vetëm si rrjedhë dhe burim lëndor në një hapësirë të caktuar tokësore. Thjesht duhet thenë : Ai nuk u nënshtrohet kënaqësive personale . Nuk kënaqet më pak dhe me mediokritete”.¹⁰⁰

Shqetësimet e pezmi , reagimi e protesta e poetit për atë që ndodh në kohën e tij, shprehet nëpërmjet ujit , i cili kushtëzon dhe ndërlihd shenjzimin dhe metaforikën e sistemit poetik të këtij krijuesi. Me spektrin e përbërësve, të simbolikës e të kuptimësisë – uji mishërohet me idetë e mendimet¹⁰¹

Te cikli “ Lumi që humbet” (botimi i parë) apo “Në vorbullën e ujit”(botimi i dytë) ai e shkruan poezinë kosmogonike me gjithë mundësitë e polimorfizimit të leximit që krijon ajo, po aty I këndon adshurisë dhe këngës(miti mbi Eurodikën dhe Orfeun, drenusha e shtrirë buzë lumit . Orfeu mitik me këngën dhe lyrën e tij mitike, arrin t’I qetësojstuhitë, t’i bëjë të ndiejnë bimët, kashët, njerëzit dhe perenditë. Ky poet e risemantizon mitin për Orfeun dhe Eurodikën . Më saktë e përmbys nëpërmes figurës së subervzionit artistik, pra me anë të pjesëve të padefinuara të semantics së mitit...¹⁰²

Miti i gjarprit në poezinë e Mirko Gashit

Për deri sa flitet për mitet e në këtë rast për mitin e gjarpërit na krijohet kundërthënie , një lloj heterogjenizmi , e para e çështjes bazike të mitit të gjarpërit që në lashtësi dhe interpretimeve poetik të mitit të gjarpërit sot nga këndvështimi fikcional i poetit në fjalë.. Çfarë në të vërtetë na thotë mitologjia lidhur me kultin e gjarpërit.

E vërejmë si gjallesë të shenjtë të tokës e të nëntokës m të shpellave e të ujërave , pra të lidhur me kultin e tokës e të ujërave . E ndeshim si hyjni mbrojtëse të jetës , të mirëqenies e mbarësisë në familje¹⁰³

Nga kjo shihet se miti i gjarpërit ka pasur një lloj hierarkie mitike, ku është respektuar qoftë nga këndi religjioz dhe marrëdhënive sociale nga bashkësitë familjare dhe më gjerë.

Nuk është e thenë që gjithnjë të prezantohet ky nocion mitik mbi gjarprin edhe nga aspekti fikcional e artistik te poetët. Sado që ky miti mund të shfrytëzohet qoftë nga këndi periferik ,pse jo me raste edhe qëndror nga ana tematike . Si e e tillë edhe kjo figure mitike nuk është e thënë të jetë gjatë gjithë kohës komplementare dhe duket se poeti Mirko Gashi e devijon këtij vij komplementariteti , thjesht jo për ta ndryshuar burimin mitik të zanafillës, por për ta rishfaqur me një segment tjetër këtë mit për gjarprin e shtëpisë. Thuaj fëmijës, Le ta vrasë, Gjarpërin e shtëpisë¹⁰⁴

Së këndejmi miti i gjarpërit të shtëpisë, si roje, si orë shtëpie, në këtë poezi merr kuptim krejt tjetër: shpreh orën e ligë, të keqen , që në vend të shpëtimit është vdekjeprurës- në lockë të zemrës të zë. E keqja është futur brenda, në shtëpi, në shpirt ka hyrë aty ku vështirë hyhet- në mit , i cili është ruajtur është bërë pjesë e pandashme e vetëdijes.¹⁰⁵

¹⁰⁰Anton Berisha, Teksti poetik, shb Rilindja, Prishtinë, 1985, fq 50.

¹⁰¹ Mirko Gashi , Polipet e vdekjes (parathënia e Prof. Dr Anton Nikë Berishës) , botoi shb Beqir Musliu , Gjilan , 2021,fq 11.

¹⁰² Prend Buzhala Gjentivi I lirikës (poezia e Mirko Gashit) shb Rozafa , Prishtinë, 2009 , 95-96

¹⁰³ Mark Tirta Mitologjia ndër shqiptarë, shb “Mësonjtorja”, Tiranë, 2004 , fq 145.

¹⁰⁴ Mirko Gashi , Polipet e vdekjes, shb Beqir Musliu, Gjilan,2021, fq 91.

¹⁰⁵ Po aty , fq 17.

Miti i kafshëve në poezinë e Mirko Gashit

Mund të duket paradoksale e me raste edhe zbërthimi i miteve të ketë zhvendosje nga një kënd eklipsues, qoftë nga zbërthimi, apo interpretimi, nëse bëhet vetëm nga njëri kënd, si e tillë nuk do t'i shërbej të dinamikës së vargut poetik të tajtuar nga poeti. Funkcional i miteve kafshë nga më të ndryshmet të formave dhe të madhësive të ndryshme, vetitë dhe veprimet e tyre, nuk janë qëllim i poetit, as qasja e tyre ekzistenciale jetësore, kjo gjë do të dukej paradoksale në receptimin e lexuesit. Qasja e elementit mitik në poezi është një tendencë për rikonfigurim funksional në varg. Ndonëse mite të tilla i hasim me një shtrirje më të gjerë gjeografike dhe etnike. Ne aspak nuk do të kishim të drejtë, nëse për një gjë tillë i qasemi, vetëm me një diskurs formal. Thjesht përmendja e miteve të kafshëve a shpendëve në poezinë e Mirko Gashit, kjo gjë nuk mjafton.

Nga një vështrim më i gjerë mes frymorit (kalit) dhe topikës varreve domosdo na del një situatë e re e interpretimit të këtij modaliteti mitik. e për këtë shprehet qartë Prof Anton Nikë Berisha :

Derisa në rrafshin mitik tradicional kjo kafshë shtëpiake (simbol i çiltërsisë), mirësisë, i dashurisë) ka nënkuptuar rojën e varreve (varret si simboli ekzistimit dhe lidhmërisë shpirtërore), rojën e shpirtave të vdekur, ka simbolizuar rojën nga e keqja që synon të futet në vetdije, në qenësinnë metafizike. Një gjë e ngjashme ndodh edhe me kuptimin e ri që marrin zogjtë Stimfalit, përkatësisht të mitit për fitore e Herakliut ndaj tyre. . Këta zogj, thotë poeti, u përbiruan nëpër legjenda dhe arritën te ne të shndërruar në zogj të tjerë (lexo: aeroplan luftarak)¹⁰⁶

Nga pozicioni i një vrojtuesi të vëmendshëm të përballjes me të keqen duket se poeti Mirko Gashi e ndjen dhe kjo përballje me të frikshmen dhe sigurisht se këto pikëtakime mes reales, fiktives dhe mitikes autori ia atribon një përshpejtimi apokaliptik ku e keqja dhe frikshmja përballet me të të pafuqishmen dhe njerëzoren.

Një gjë e ngjashme ndodh edhe me, si thotë Mirko Gashi, kalorësin e pestë të Apokalipsisë, frikën. Kushtet, rrethanat në të cilat veprroi dhe frymoi, poeti dhe bashkëkohësit e tij, ndikuan që frika të marrë përmasën e shkatërruesit të botës sikur uria, murtaja, lufta dhe vdekja. Frika është bërë pjesë e gjallimit shpirtëror, prandaj është bërë shkatërruese dhe pasojat janë dukshme, sidomos kur zogu I urtëi marrës, fle në kokat e idhujve.¹⁰⁷

Përfundim

Në përmbyllje të këtij punimi, mund të themi, se u pa qartë se poeti Mirko Gashi, thjesht nuk tenton që inkuadrimit të miteve, ta bëjë një lloj relativizmin formal. Pozicioni i miteve dhe gërshetimin e tyre nga një kënd tjetër, në thellësinë e tyre u pa se ka shumë më shumë se kaq. Përveç atraktiviteti artistik, përveç unitetit kompozicional të vargut, ai mitin e dërgon ka një asimetri tjetër, për të qenë më i qartë lexuesi, se ato kode mitike dhe këtë rast të inkuadruara si simbolika poetike na dërgojnë tenjë realitet I pafvorshëm në kohën kur poeti krijoi dhe jetoj me rrethanat e kohës.

¹⁰⁶ Mirko Gashi, Polipet e vdekjes, (Parathënie nga Prof Anton N Berisha) sh b Beqir Musliu, Gjilan 2021, fq 18

¹⁰⁷ Po aty fq 18-19.